



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
KËSHILLI SHKENCOR

Nr. ~~223~~ / prot
2

Tiranë më 15 / 10 / 2025

PROCESVERBAL

MBLEDHJE KËSHILLI SHKENCOR

(Datë, 15 .10.2025)

Të pranishëm nga Këshilli Shkencor: Z. Ardian Muhaj, Z. Edlir Orhani, Znj. Znj Gentiana Kera, Znj. Ines Stasa.

Rendi i ditës:

1. Diskutim mbi kolanën e botimeve të ISKK- së

Hapet mbledhja.

Në këtë mbledhje mori pjesë Përgjegjësja e Sektorit të Kërkimit Shkencor për të diskutuar lidhur me kolanën e librave 2026.

Mbledhja u hap nga Përgjegjësja e Sektorit të Kërkimit Shkencor, Brisejda Lala, e cila ndau me anëtarët e Këshillit Shkencor listën e kolanës së librave për vitin 2026. Dorëshkrimet do ti kalojnë Këshillit Shkencor për shqyrtim dhe më pas do të kalojnë në procesin e botimit. Janë rreth 7 deri në 9 botime që do të hyjnë në botim në vitin 2026. Do të dëshironim që ky process të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të kalojnë në proces redaktimi.

Z. Ardian Muhaj: Mendoj që librat mund ti sillni edhe një nga një, kush është gati.

Znj. Gentiana Kera: Librat është mirë që të kalojnë të gjitha njëherësh që ti diskutojmë në mbledhje dhe ti që ti ndajmë.

Znj. Brisejda Lala: Fillimisht do ju dërgojmë librat e ardhur nga autorët e jashtëm. Revista Memoria dhe Zërat e Kujtesës, si edhe librat që do të botohen nga autorë të brendshëm do ju dërgohen më vonë. Do keni të paktën 2 muaj kohë për ti parë librat.

Z. Ardian Muhaj: Duhet të diskutojmë gjithashtu edhe për rregulloren e botimeve.

2. Të miratohet një raport lidhur me qëndrimin e Kuvendit për të shpallur Enver Hoxhën për të qënë pjesë e listës së personave që do të përkujtohen për muajin Tetor.

Ines Stasa: Minimalisht mund të bëjmë një rishikim të rezolutave të bëra deri tani mbi figurën e Enver Hoxhës. Të na niset një draft për raportin që të përpunojmë.

Ardian Muhaj: Kjo është një ccështje e rëndësishme që kërkon koordinimin e të gjitha hallkave.

Gentiana Kera: Ky do të jetë një reagim nga Instituti që do të kalojë edhe nëpërmjet Këshillit Shkencor.

Vendime:

1. Të dërgohen të gjithë dorëshkrimet e autorëve të jashtëm Këshillit Shkencor për ti marrë në shqyrtim.
2. Të miratohet një qëndrim lidhur me qëndrimin e Kuvendit për të shpallur Enver Hoxhën për të qënë pjesë e listës së personave që do të përkujtohen për muajin Tetor.
3. Të vendosen fotot të anëtarëve të Këshillit Shkencor në Web me apo pa bio të shkurtër.

Mbledhja mbyllet.

Ardian Muhaj Kryetar.....

Edlir Orhani Anëtar.....

Gentiana Kera Anëtar.....

Ines Stasa Anëtar.....

Përpiloi: Daniela Runa

